



REPUBLICA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
 KOMUNA JUNIK
 OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



REFERENC-Ë:	Numër: 12-02/23
PËR/ZA/TO:	Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik
NGA/OD/FROM	Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik
DATË/A	29.12.2023
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Procesverbal

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut, dhe nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, KK - Junik mbanë këtë:

PROCESVERBAL

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së dymbdhjetë (12) të Kuvendit të Komunës së Junikut, me datë: 29.12.2023, duke filluar në ora 10:00. Mbledhjen e hapi dhe e udhëhoqi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Junikut: z. Shpejtim Gacaferi: i cili në fillim përshëndeti, Kryetarin e Komunës së Junikut z.Ruzhdi Shehu, drejtorët e drejtorive komunale, anëtarët të Kuvendit Komunal, zyrtarët Komunal dhe gjithë të pranishmit me pas konstatoi se mbledhje marin pjese te 12 antaret e kuvendit. Në mbledhje nga drejtoret prezent ishin: znj.Leunora Shehu-AD, znj.Gentiana Tofaj-DEZH, z.Xhavit Velijaj DAKRS, z.Fatos Shala-DSHMS dhe z.Zenun Shala DUKM.

Më pas Kryesuesi i Kuvendit, z.Shpejtim Gacaferi, kerkoj nje minut heshtje per z.Mic Tofaj dhe znj.Fatlinda Maloku-Tofaj, qe humben jeten tagjikisht ne bjeshket e Junikut. Nje minut heshtje-LAVDI, me pas kryesuesi u shpreh : ju shprehi ngushllime ne emerin tim dhe te Kuvendit te Komunes se Junikut te dy familjeve, familjes Tofaj dhe Familjes Maloku.

Anëtarët prezent

- | | |
|---|---|
| <ol style="list-style-type: none"> 1. Shpejtim Gacaferi - Kryesues, LDK 2. Sadri Krasniqi – Anëtar, LDK 3. Alfred Gaxherri - Anëtar, LDK 4. Mursel Salihaj-Anëtar,LDK 5. Ermelinda Llluni - Anëtare, LDK | <ol style="list-style-type: none"> 10. Rajmonda Krasniqi - Anëtare, AAK 11. Erleta Qestaj - Anëtare, AAK 12. Festina Maloku - Anëtare, AAK 13. Lulzim Gacaferi- Anëtar, LVV |
|---|---|

- | | |
|-------------------------------------|------------------------------|
| 6. Lirjeta Shehu - Anëtare, LDK | 14. Eliza Pepshi-Anëtare,LVV |
| 7. Leonard Lolluni - Anëtar, AAK | 15. Xhemë Tofaj-Anëtar LVV |
| 8. Zenel Maloku - Anëtar, AAK | |
| 9. Dervish Bajraktari - Anëtar, AAK | |

Rendi i ditës i paraparë

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Kuvendit dhe orari i mbajtjes së takimeve të rregullta të Kuvendit Komunal për vitin 2024 (leximi i dytë)
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2024,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2024,
6. Shqyrtimi i Raportit të Planit të Integritetit për vitin 2023,
7. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit,
8. Të ndryshme.

z.Shpejtim Gacaferi, kerkese tjeter rrethe rendit te dites nuk , e qes ne votim rendin e dites te propozuar per mbledhjen e sotit, kush eshte per, per 12 vota, kunder 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se rendi i dites u miratua.

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,

z.Shpejtim Gacaferi, ne kete mbledhje mungojne: z.Zenel Maloku
znj.Festina Maloku
z.Alfred Gaxherri

z. Shpejtim Gacaferi arsyetoj mos pranin e z. Zenel Maloku , edhe per kunder faktit qe e dimë të gjithë ne fatkeqësinë familjare qe i ka ndodh kolegut tonë prap z. Maloku permes telefonit me ka njoftu se nuk mund te jetë i pranishem ne kete mbledhje , une e arsyetoj dhe e falenderoj per sjelljen e tijë korrekte .

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,

z.Shpejtim Gacaferi, kerkesë tjeter rrethe procesverbalit nuk ka, prezent ne salle jane 11 antaret e kuvendit, e qes ne votim procesverbalin e mbledjes se kaluar, kush eshte per, per 11 vota, kunder 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se procesverbali i mbledhjes se kalura u miratua.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Kuvendit dhe orari i mbajtjes së takimeve të rregullta të Kuvendit Komunal për vitin 2024 (leximi i dytë)

Shqyrtimin dhe arsyetimi e planit te punes se kuvendit e beri z.Shpejtim Gacaferi kryesues i Kuvendit.

z.Shpejtim Gacaferi, kerkese tjeter nuk ka prezent ne salle jan 11 antaret e kuvendit, e qes ne votim kush eshte per, per 11 vota, kunder 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se plani i punes se kuvendit per vitn 2024 u miratua.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2024,

Shqyrtimi dhe arsyetimin e planit te punes se KKSB e beri z.Besart Tofaj, nenkryetari i Komunes se Junikut i cili fillimisht i pershendeti te gjithë te pranishmit me pas e sqaroi dhe e arsyetoia planin e pune s se KKSB .

z.Shpejtim Gacaferi, kerkese tjeter nuk ka, konstatoi se ne salle jane 11 antaret e kuvendit, e qes ne votim planin e punes se KKSB per vitin 2024, kush eshte per, per 11 vota, kunder 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se plani i pune se KKSB per vitin 2024 u miratua.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2024,

Shqyrtimin dhe arsyetimi e planit te punes se Komitetit per komunitete ne munges te kryesuesit te keti komiteti e beri z.Shpejtim Gacaferi kryesues i Kuvemit.

z.Shpejtim Gacaferi, kerkese tjeter nuk ka konstatoi se ne salle jane 11 antar te kuvemit, e qes ne votim plani e pune s se komitetit per komunitetet, kush eshte per, per 11 vota kunder 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se plani i pune s se komiteti per komunitete u miratua.

6. Shqyrtimi i Raportit të Planit të Integritetit për vitin 2023,

Shqyrtimi dhe arsyetimin e raportit te planit te integritetit per vitin 2023 e beri z.Rrustem Pepshi kryesues i komisionit, i cili fillimisht i pershendeti te gjithë me pas e sqaroi dhe e arsyetoia para anatareve te kuvemit raportin.

z.Lulzim Gacaferi, pershendetje per te gjithë, sa i perkete transparences qe u fol ne kete raport dhe sa i perkete qasjeve ne dokumente publike, une kam bere nje kerkese me shkrim ne drejtorin e urbanizimt lidhur me lejen e ndertimit per objektin ketu ne oborrin e komunes dhe nuk me jane dhen dokumentet qe une i kam kerkuar.

z.Rrustem Pepshi, sa i perkete kesaj kerkese ne na eshte ofruar pergjigjeja qe ju ka kthyer z.Lulzim Gacaferi dhe ne baze te kesaj ne ne raport e kemi si pergjigje te kthyer sepse nje pergjigje ju ka ktheyr z,lulzim Gacaferi.

z.Zenun Shala, pershendetje per te gjithë, ne z.Lulzim Gacaferi ja kemi kthyer nje pergjigje, dhe ne ate pergjigje e kemi njoftuar se ato dokumete qe i ka kerkuar mundet me ar dhe me i pa ne zyren e drejtoris se urbanizimit.

z.Ruzhdi Shehu, pershendetje per te gjithë, shiqoni duhet te kemi kujdes sa i perketë dokumenteve publike, disa dokumente nuk lejhone me ligje qe te dalin jashte objektit te komunes dhe qasja ne to lejohet vetem ne prezent te zyrtari dhe ne objekt te komunes, mirepor nese eshte kerkuar ndonje dokument qe mundet me ju dhan edhe jasht objektit ateher kan te derjet ta kerojon dhe ai dokument duhet ti ipet.

z.Shpejtim Gacaferi, kerkese tjeter nuk ka raportet nuk votohen kalojme ne pikne e rendit te dites me radhe.

7. Pyetje nga anëtarër e Kuvendit

z. Lulzim Gacaferi pyetje per Drejtorin z. Xhavit Velijaj me sa kam informacion keni kalu ne objektin e ri te shkolles, si qendron puna a jeni kompletuar me paisjet e nevojshme dhe a ka nxemje te mjaftueshme qe nxenesit te ndihen komod dhe moe te ken ndonje problem rreth kushteve.

z. Xhavit Velijaj po e vertet kemi fillu keto ditë me mbajtë mesimin ne objektin e ri te shkolles, mesimi mbahet ne nje ndrrim vetem ndrrimi i paradites pasi qe ka hapësirë të mjaftueshme edhe nxemje ka normal aq sa paraqitet nevoja jemi te paisur mjaftueshem me lenden per ngrohje (pelet) pasi qe kalldaja e re funksionon me pelet, probleme nuk kemi , kemi pak problem me munges te nje gjeneratori se nese ndalet rryma paraqitet nevoja qe ky gjenerator te kyqet dhe te jetë me kapacitet te mjaftueshem per objektin e shkolles te pakten per me kyq pompat e nxemjes.

z. Lulzim gacaferi u interesua rreth kapacitetit te gjeneratorit dhe pyeti drejtorin se a jeni ne dijeni per koston e keti gjeneratori se sa kushton nese blehet i ri.

z. Xhavit Velijaj jo nuk jam ne dijeni per kapacitetin dhe per qmimin se sa mundet me kushtu ky gjenerator jemi ka punojmë në atë drejtim, kemi mendu qe mos po e blejm te ri per objektin e Komunes e gjeneratorin qe e posedojmë ne objektin e komunes me e kalu te objekti i shkolles mendoj qe shpejtë do ta bejmë nje zgjidhje.

z. Lulzim Gacaferi me uren qe eshte perfunduar qe i lidh dy fshatrat Jasiq e Gjocaj me Junikun mendoj qe është bërë një punë e mirë, me vjen shum mirshof qe punohet per Junikun vendin tim.

Me kaq kryesuesi e shpalli te mbyllur mbledhjen e rregull dhe te fundit për vitin 2023, mbledhja perfundoj ne ora 11.30

Procesmbajtësi:

z. Esat Hoxha

Kryesuesi i Kuvendit:

z. Shpejtim Gacaferi
